

Folklori

Në këtë rajon janë ruajtur shumë tradita kombëtare si në veshje, instrumenta, këngë etj. Prandaj për ofertën turistike të rajonit është mjaft e rëndësishme organizimi i manifestimeve folklorike dhe format tradicionale të jetës e veprimtarisë së tij.

Turizmi nëpërmjet manifestimeve kulturore dhe vleresimit të tyre ndikon në ruajtjen e folklorit, kultivimin e tij dhe ngritjen e nivelit artistik të tyre.

Rajoni trashëgon dhe kultivon një thesar të pasur e të bukur folklorik ku pasqyrohet vitaliteti, kultura materiale dhe shpirtërore dhe ndenja fisnike. Është e vërtetë që kostumet popullore dhe orendite e traditës nën përvetësimin e jetës moderne janë zhdukur nga përdorimi i përditshëm, por ato mund të shihen dhe gjenden me tërë bukurinë dhe finesën e tyre artistike në manifestimet folkloristike e në muzetë etnografikë.

Për mungesë ambientesh nuk funksionon një muze, por potencon gjithë inventarin e veshjeve popullore të Qarkut të Lezhës dhe shquhet për vlerat burimore , të cilat ruhen mirë.

Në Lezhë ka vite që zhvillohet Festivali i Lahutarëve ,në të cilin marrin pjesë nga gjithë Veriu i Shqipërisë dhe nga vise të tjera të Ballkanit.